

PROCESVERBAL

nga mbledhja e shtatë të Komisionit për përmbajtjet programore në gjuhën shqipe dhe gjuhët e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe bashkësive tjera nacionale.

Mbledhja e Komisionit u mbajt me 23 shtator 2022

Në mbledhje morën pjesë:

1. Admir Adroviq, kryetar;
2. Veron Halili, anëtar;
3. Tripo Matijeviq, anëtar;
4. Ivana Krushçiq, anëtare;
5. Mirheta Gaçeviq, anëtare.

Frashër Selimaj, anëtar, nuk mori pjesë në mbledhje për shkaqe të obligimeve të mëparshme, për ç'gjë e njoftoi kryetarin e Komisionit.

Krahas anëtarëve të Komisionit, në mbledhje mori pjesë edhe Ivan Lekoviq, sekretar i Komisionit.

Në mbledhje u miratua

RENDI I DITËS

1. Diskutimi dhe deklarimi për Procesverbalin nga mbledhja e gjashtë e rregullt e Komisionit.;
2. Diskutimi dhe deklarimi për propozimin e Ivana Krushçiq që emisioni, "Srpska kulturna scena u Crnoj Gori i regionu- Skena kulturore serbe në Mal të Zi dhe rajon", të përfshihet në Planin programor dhe të produksionit të TVMZ për vitin 2023;
3. Të ndryshme.

I

Procesverbali nga mbledhja e gjashtë e rregullt e Komisionit u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm. (5 vota PËR).

II

Admir Adroviq e lexoi propozimin, i cili në rast të fitimit të pajtimit të anëtarëve të Komisionit do të duhej ti dërgohej Këshillit të RTMZ, në formë të iniciativës. Me propozimin e cekur parashihet emetimi i serialit televiziv prej 28 emisioneve, nga 30 minuta. Qëllimi është që përmes përcjelljes dhe afirmimit të manifestimeve, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e identitetit kulturorë, gjuhësorë dhe fetarë të popullit serb në Mal të Zi, afirmohet, kultivohet dhe ruhet veçantia e tij identitare. Krahas të cekurës, seriali do të përcillte edhe lidhjet e popullit serb me popujt dhe bashkësitë tjera.

Ivana Krishçiq theksoi se emisionet ekzistuese në Servisin publik, të cilat i përcjellë Komisioni, asnjëra nuk merret me tematikën e propozuar.

Tripo Matijeвиќ konsideron se bëhet fjalë për lëshim organizativ. Krahas kësaj, ai ceku se në përbërjen e kaluar të Komisionit nuk kishte përfaqësues të popullit serb, dhe dilemës nëse qëndron çështja nëse bëhet fjalë për popull konstituiv apo të pakicave dhe nuk do të paraqiste pengesë për thelbin e punës të Komisionit, dhe se pajtohet që ti dërgohet Këshillit të RTMZ iniciativa për çështjen e cekur. Gjithashtu theksoi se ka edhe disa dilema: nëse emisioni duhet të realizohet si e veçantë ose tema e propozuar të trajtohet përmes emisioneve ekzistuese apo me karakter të ri të përbashkët. Krahas kësaj, ai konsideron se nëse autori nuk do të ishte nga RTMZ, a do të nënkuptonte kjo që mjetet për realizimin e tij duhet të sigurohen nga Fondi për popujt pakicë dhe bashkësitë tjera.

Mirheta Garçeviq konsideron se me propozimin e emisionit të cekur do të përzihemi në politikën redaktuese të RTMZ. Krahas kësaj, ajo pyeti se kush do të ishte bartës i serialit.

Ivana Krushçiq sqaroi se sipas mendimit të saj, seriali do të duhej të realizohej nga ana e të punësuarve të RTMZ si dhe mjetet të cilat disponon Servisi publik.

Tripo Matijeвиќ përsëriti se në parim pajtohet me propozimin e serialit, dhe me këtë konsideron se krahas emisioneve ekzistuese do të duhej të propozohej emetimi i emisionit të ri që do të përfshinte trashëgimin kulturore e të gjithë popujve pakicë e bashkësive tjera, sepse sipas tij, ekzistojnë tema të shumta të cilat do të mund të kandidohen. Lidhur me këtë, ai veçoi arkitekturën, letërsinë, legjendat. Poashtu theksoi se vetëm në Bokën e Kotorit ka shumë objekte fetare me rëndësi historike për publikun e gjerë në Mal të Zi, që pothuajse plotësisht janë të panjohura.

Mirheta Garçeviq theksoi se në princip pajtohet me Tripo Matijeвиќ, dhe se është e vetëdijshme me problemet me të cilat ballafaqohen popujt pakicë e bashkësitë tjera në Mal të Zi. Gjithashtu ceku se me propozimin e serialit nuk e ka të qartë se çka nënkupton pjesa e cila ka të bëjë lidhshmëria e kulturës serbe me kulturat e popujve pakicë. Ajo konsideron se emërtimi i emisionit implikon përfshirjen vetëm të popullit serb.

Ivana Krushçiq theksoi se këto do të ishin promovime të ndryshme kulturore, manifestime, si për shembull, “Njegosëvi dani- Ditët e Njegoshit”, “Dani Roma- Ditët e Romëve”, si dhe shumë të tjera.

Propozimi i Ivana Krushçiq që iniciativa me serialin e propozuar ti dërgohet Këshillit të RTMZ u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm. (5 vota PËR)

III

Në kuadër të pikës, Të ndryshme, nuk kishte tema për diskutim.

PROCESVERBALIN E PUNOI
Ivan Lekoviq

KRYETARI I KOMISIONIT
Admir Adrovic